

8.02.2000
Z. Sh. Sh. Sh.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 8 , datë 13.1.2000

P Ë R

NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.378, DATE 12.8.1999, "PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PËRFAQËSUESIT TË PRONARIT PËR DISA OBJEKTE PRONË PUBLIKE, ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të ligjit nr.8482, datë 10.5.1999, "Për një shtesë në ligjin nr.7926, datë 10.5.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndryshuar me akte të tjera ligjore, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në listën e objekteve, për të cilat kalohet e drejta e përfaqësuesit të pronarit për pronën shtetërore, organeve të qeverisjes vendore, shtohen ndërmarrjet sipas listës së bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

ILIR META

Ilir Meta

MINISTRI I EKONOMISË
PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT
ZEF PREÇI

NË MUNGESË DHE ME POROSI
ZËVENDËSMINISTRI

VIKTOR/DODA

*Vydhoshet qe me organet
Drejtën
Përmes ngjall
Viktor Doda*



NR. PROT. 118/1
DATE 17.1.2000

MINISTRISË SE DREJTESISË
MINISTRISË SE EKONOMISË
PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT
MINISTRISË SE PUSHTETIT VENDOR
MINISTRISË SE FINANCEVE
QENDRES SE PUBLIKIMEVE ZYRTARE

SEKRETARI I PERGJITHSHEM

QIRJAKO QIRKO



*Vydhoshet qe me organet
Drejtën
Përmes ngjall*



Lista e shoqerive / ndërmarrjeve prone publike, per kalimin e se drejtes se perfaqesuesit te pronarit

| Nr. | Shoqeria / Ndermarja | Statusi | Rrethi | Qyteti | Vartesia administrati |
|-----|-------------------------------------|----------------------------------|----------------|----------------|-----------------------|
| 1 | Mekanika Industrise Ushqimore Sh.A. | Shoqeri Anonime | Elbasan | Elbasan | Lokale |
| 2 | N. G. P. Drithi Sh.A. | Shoqeri Anonime | Korçe | Korçe | MBU |
| 3 | Shoqeri Maliq Sh.A. | Shoqeri Anonime | Korçe | Maliq | MBU |
| 4 | Alimpeks Sh.A. | Shoqeri Anonime | Tirane | Tirane | MBU |
| 5 | Fondermek Sh.A. | Shoqeri Anonime | Tirane | Tirane | MEPP |
| 6 | IB. ALB ELECTRONICS Co. | Shoqeri e perbashket ne likuidim | Durres | Durres | MEPP |
| 7 | Dega N.F.I.L. | Ndermarje Shtetërore | Berat | Berat | MEPP |
| 8 | Tezgjahu Nr. 1 | Ndermarje Shtetërore | Berat | Berat | MEPP |
| 9 | N. Prodhim Buke | Ndermarje Shtetërore | Bulqize | Bulqize | MBU |
| 10 | N. G. P. Drithi | Ndermarje Shtetërore | Diber | Peshkopi | MBU |
| 11 | N. G. P. Qumshiti | Ndermarje Shtetërore | Diber | Peshkopi | MBU |
| 12 | N. Blojes nr. 1 | Ndermarje Shtetërore | Diber | Peshkopi | MBU |
| 13 | N. Blojes nr. 2 | Ndermarje Shtetërore | Diber | Peshkopi | MBU |
| 14 | N. Riveshje Goma | Ndermarje Shtetërore | Durres | Durres | MEPP |
| 15 | Uzina M. Bujqesore | Ndermarje Shtetërore | Durres | Durres | MEPP |
| 16 | N. Tregeti me Shumice | Ndermarje Shtetërore | Durres | Durres | MBET |
| 17 | Makinaimpeks | Ndermarje Shtetërore | Durres | Durres | MBET |
| 18 | N. Frigoriferit | Ndermarje Shtetërore | Durres | Durres | MBET |
| 19 | Dega N. F. I. L. | Ndermarje Shtetërore | Elbasan | Elbasan | Lokale |
| 20 | Uzina Seleksionimit Koksit | Ndermarje Shtetërore | Elbasan | Elbasan | MEPP |
| 21 | Uzina Seleksionimit Metaleve | Ndermarje Shtetërore | Elbasan | Elbasan | MEPP |
| 22 | N. Prodhimit Bukes | Ndermarje Shtetërore | Fier | Patos | Lokale |
| 23 | Dega N. T. P. N. | Ndermarje Shtetërore | Fier | Fier | MBET |
| 24 | Uzina Pilave | Ndermarje Shtetërore | Fier | Fier | MBET |
| 25 | N. Agrotregtare | Ndermarje Shtetërore | Gramsh | Gramsh | MM |
| 26 | N. G. P. Drithi | Ndermarje Shtetërore | Has | Has | MBU |
| 27 | N. G. P. Drithi | Ndermarje Shtetërore | Has | Has | MBU |
| 28 | Fabrika Qelqit | Ndermarje Shtetërore | Has | Has | MBU |
| 29 | Fabrika Shteriferike (N. Ushqimore) | Ndermarje Shtetërore | Kavaje | Kavaje | MEPP |
| 30 | Dega Fierbimit Gjeologjik | Ndermarje Shtetërore | Kolonje | Erseke | MBU |
| 31 | N. Trikotazhit | Ndermarje Shtetërore | Korçe | Korçe | MEPP |
| 32 | Uzina Instrumentave | Ndermarje Shtetërore | Korçe | Korçe | MEPP |
| 33 | Uzina Mekanikes Bujqesore | Ndermarje Shtetërore | Korçe | Korçe | MEPP |
| 34 | N. T. P. N. | Ndermarje Shtetërore | Korçe | Korçe | MEPP |
| 35 | N. T. P. N. | Ndermarje Shtetërore | Korçe | Korçe | MEPP |
| 36 | N. G. P. Drithi | Ndermarje Shtetërore | Korçe | Korçe | MEPP |
| 37 | A. Sh. I. D. | Ndermarje Shtetërore | Kurbin | Mamurras | Lokale |
| 38 | Fabrika e Letres Lingosullonat | Ndermarje Shtetërore | Kurbin | Laç | MBU |
| 39 | N. G. P. Drithi | Ndermarje Shtetërore | Kurbin | Laç | Lokale |
| 40 | N. G. P. Drithi | Ndermarje Shtetërore | Kurbin | Laç | Lokale |
| 41 | N. G. P. Drithi | Ndermarje Shtetërore | Kurbin | Laç | Lokale |
| 42 | N. G. P. Drithi | Ndermarje Shtetërore | Kurbin | Laç | Lokale |
| 43 | N. G. P. Drithi | Ndermarje Shtetërore | Kurbin | Laç | Lokale |
| 44 | N. G. P. Drithi | Ndermarje Shtetërore | Kurbin | Laç | Lokale |
| 45 | Dega Farnave | Ndermarje Shtetërore | Lezhe | Lezhe | Lokale |
| 46 | N. Bonifikimit | Ndermarje Shtetërore | Lezhe | Lezhe | Lokale |
| 47 | P. A. M. | Ndermarje Shtetërore | Lezhe | Lezhe | MBU |
| 48 | A. Sh. I. D. | Ndermarje Shtetërore | Lezhe | Lezhe | Lokale |
| 49 | Dega Farnave | Ndermarje Shtetërore | Lezhe | Lezhe | Lokale |
| 50 | N. Jometalore | Ndermarje Shtetërore | Lezhe | Lezhe | Lokale |
| 51 | N. Lendes Ngjitese | Ndermarje Shtetërore | Librazhd | Librazhd | Lokale |
| 52 | Fabrika Rreres (Autotraktori) | Ndermarje Shtetërore | Lushnje | Lushnje | MBU |
| 53 | N. Bonifikimi | Ndermarje Shtetërore | Malesi e Madhe | Malesi e Madhe | MBU |
| 54 | N. Pasurimit Graniteve | Ndermarje Shtetërore | Mat | Mat | MBU |
| 55 | U. P. N. A. | Ndermarje Shtetërore | Mat | Mat | MBU |
| 56 | Uzina Remontit Makinave Metalprorse | Ndermarje Shtetërore | Mat | Mat | MBU |
| 57 | N. Sherbimeve Mekanike | Ndermarje Shtetërore | Mat | Mat | MBU |
| 58 | Uzina Kimike e Ushtrise | Ndermarje Shtetërore | Mat | Mat | MBU |

Lista e shoqerive / ndërmarrjeve prone publike, per kalimin e se drejtes se perfaqesuesit te pronarit

| | | | | | |
|----|-------------------------------------|----------------------|----------|----------|--------|
| 45 | Dega Farnave | Ndermarje Shtetërore | Pogradec | Pogradec | MBU |
| 46 | N. Bonifikimit | Ndermarje Shtetërore | Pogradec | Pogradec | Lokale |
| 47 | P. A. M. | Ndermarje Shtetërore | Pogradec | Pogradec | MT |
| 48 | A. Sh. I. D. | Ndermarje Shtetërore | Sarande | Sarande | MBU |
| 49 | Dega Farnave | Ndermarje Shtetërore | Shkoder | Shkoder | MBU |
| 50 | N. Jometalore | Ndermarje Shtetërore | Shkoder | Shkoder | MBU |
| 51 | N. Lendes Ngjitese | Ndermarje Shtetërore | Sikoder | Sikoder | Lokale |
| 52 | Fabrika Rreres (Autotraktori) | Ndermarje Shtetërore | Tirane | Tirane | MEPP |
| 53 | N. Bonifikimi | Ndermarje Shtetërore | Tirane | Tirane | Lokale |
| 54 | N. Pasurimit Graniteve | Ndermarje Shtetërore | Tirane | Tirane | Lokale |
| 55 | U. P. N. A. | Ndermarje Shtetërore | Tirane | Tirane | Lokale |
| 56 | Uzina Remontit Makinave Metalprorse | Ndermarje Shtetërore | Tirane | Tirane | MEPP |
| 57 | N. Sherbimeve Mekanike | Ndermarje Shtetërore | Tirane | Tirane | MEPP |
| 58 | Uzina Kimike e Ushtrise | Ndermarje Shtetërore | Tirane | Tirane | Lokale |

*Vydhoshet qe me organet
Drejtën
Përmes ngjall*



VENDIM

Nr. 41, datë 21.1.2015

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.378, DATË 12.8.1999,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN E SË DREJTËS
TË PËRFAOËSUESIT TË PRONARIT PËR DISA OBJEKTE, PRONË
PUBLIKE, ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE",
TË NDRYSHUAR

mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr.7926,
të 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri
qytetare", të ndryshuar, të neneve 13, 14 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001,
"Për pasuritë e paluajtshme shtetërore", të ndryshuar, të nenit 8/a, të ligjit
nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të
titullit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit
Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Në listën e objekteve, që i bashkëpëlidhet vendimit nr.378, datë 12.8.1999,
të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të hiqet prona me emërtimin
"Sheqeri Maliq", sh.a.
- Prona "Sheqeri Maliq", sh.a., përmendur në pikën 1, të këtij vendimi,
transferohet në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Zhvillimit
Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Prokuror Bego

1

Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes,
Ministria e Punëve të Brendshme dhe bashkia Maliq për zbatimin e këtij
vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

ARBEN AHMETAJ

Prokuror Bego

2

NR.PROT.181/1
DATË 23.1.2015

MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTRISË SË BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
BASHKISË SË MALIQIT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

Engjell Agaci

Prokuror Bego



Tiranë – E mërkurë, 23 maj 2018

PËRMBAJTJA

Faqe

| | | |
|--|---|------|
| Rezolutë e Kuvendit datë 17.5.2018 | Për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2017..... | 4655 |
| Rezolutë e Kuvendit datë 17.5.2018 | Për vlerësimin e veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2017..... | 4656 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 264, datë 16.5.2018 | Për një ndryshim në vendimin nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", të ndryshuar..... | 4657 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 265, datë 16.5.2018 | Për disa shtesa në vendimin nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar", të ndryshuar..... | 4657 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 266, datë 16.5.2018 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 184, datë 29.3.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për hapjen e procedurave e të kriterëve të pranimit në kategorinë e ulët drejtuese edhe për kandidatët të tjerë, jashtë shërbimit civil, për vitin 2018"..... | 4658 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 267, datë 16.5.2018 | Për miratimin e deklaratës së synimit (SOI – Statement of Intent), të Republikës së Francës për çu bërë pjesë e Memorandumit të Mierkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Forcave Aleate në Evropë dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, lidhur me mbështetjen e shtetit pritës për kryerjen e operacioneve dhe të stërvitjeve të Nato-s..... | 4661 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 268, datë 16.5.2018 | Për kalimin në pronësi të Bashkisë Devoll, në Njësinë Administrative "Qendër Bilisht", të disa pronave me vendndodhje në zonat kadastrale 3637 dhe 1202..... | 4667 |

Adresa: Rruga "Nikolla Jorga", Tiranë; Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

| | | |
|--|--|------|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 271, datë 16.5.2018 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 646, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave e të kriterëve të përzgjedhjes së zhvilluesit në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik"..... | 4668 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 272, datë 16.5.2018 | Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë "Kombinati i Sheqerit" sh.a., Maliq, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Bashkia Maliq..... | 4670 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 273, datë 16.5.2018 | Për krijimin e Regjistrat Qendror të Bazës së Dhënave për Llogaritjen e Taksës Vendore të Pasurisë së Paluajtshme "Ndërtesë" (kadastra fiskale)..... | 4671 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 274, datë 16.5.2018 | Për kalimin në pronësi nga shoqëria Aeroporti "Nënë Tereza" sh.a., Tiranë, te shoqëria "Albcontrol" sh.a., Tiranë, të dy pasurive..... | 4673 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 275, datë 16.5.2018 | Për përcaktimin e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme..... | 4673 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 276, datë 16.5.2018 | Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar..... | 4674 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 278, datë 16.5.2018 | Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore "Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)"..... | 4683 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 280, datë 16.5.2018 | Për mbulimin e shpenzimeve të transportit mjekësor të z. Luan Hajdaraga..... | 4686 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 16.5.2018 | Për organizimin dhe funksionimin e sekretariatit teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar dhe përcaktimin e ministrit përgjegjës për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 57/2014, "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Ekonomik Kombëtar", të ndryshuar..... | 4686 |

Fletorja Zyrtare **Viti 2018 – Numri 74**

5. Institucioni përgjegjës, në përputhje me nenin 4, të ligjit, i propozon Këshillit të Ministrave shpalljen e zonës dhe zhvilluesin e saj.

Neni 10

Pas nenit 15 shtohet neni 15/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 15/1

Shqyrtimi i ankimit administrativ

Për shqyrtimin e ankesave administrative, institucioni përgjegjës ndjek hapat, si më poshtë vijon:

1. Titullari i institucionit përgjegjës urdhëron ngritjen e një komisioni të përbërë nga 3 (tre) anëtarë, ku, të paktën, njëri është ekspert i fushës, për të shqyrtuar ankesën dhe përparjen e një vendimi të arsyetuar. Komisioni i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës.

Anëtarët e komisionit, të ngarkuar për shqyrtimin e ankesës, nuk duhet të kenë qenë pjesë e vendimmarrjes, për të cilën është paraqitur ankesa.

Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e konkurrimit, titullari i autoritetit kontraktor mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

2. Njësia e hartimit të dokumenteve mbledh dhe vendos në dispozicion të komisionit të ngarkuar për shqyrtimin e ankesës gjithë informacionin e nevojshëm për shqyrtimin e saj.

3. Vendimi në lidhje me ankesën duhet të merret brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e saj. Nëse nga ankuesi kërkohet informacion shtesë, atëherë afati kohor i sipërpërmendur ndërpritet dhe rifillon pasi institucioni përgjegjës ta sigurojë këtë informacion.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e saj merret vendim të arsyetuar për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të institucionit përgjegjës.

Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i institucionit përgjegjës i adreson vendimin për zbatim Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Në çdo rast, vendimi i institucionit përgjegjës i komunikohet me shkrim ankimesit. Për efekt të shkruarimit të afatit kohor të procesit të ankimit, komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e

Faqe | 4670

ankesës ia komunikon vendimin ankimesit edhe në adresën elektronike të përcaktuar prej tij në formularin e ankesës, jo më vonë se ditën e nesërme të punës, pas marrjes së vendimit.

4. Institucioni përgjegjës, nëse nevojitet, duhet të zgjatë afatin kohor të procedurës së konkurrimit aq sa zgjat periudha e pezullimit. Në rastet kur afatet kohore të procedurës së konkurrimit, për të cilat janë njoftuar ofertuesit, ndryshojnë, për shkak të marrjes parasysh të ankesës, autoriteti kontraktor u shpërndan ofertuesve një njoftim të posaçëm, ku jepen arsyet për zgjatjen e këyre afatëve.

Neni 11

Në fund të nenit 18 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Në rast të veçanta, me kërkesë të argumentuar të grupit të negociimit të kontratës, institucioni përgjegjës mund ta ndryshojë këtë afat. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcione me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM
Nr. 272, datë 16.5.2018

PËR TRAJTIMIN E PRONËSISË SË 100% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË "KOMBINATI I SHEQERIT" SHA, MALIQ, NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË TË BASHKIA MALIQ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, të neneve 3 e 4 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

Fletorja Zyrtare **Viti 2018 – Numri 74**

VENDOSI:

1. Transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë "Kombinati i sheqerit" sh. a., Maliq, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Bashkia Maliq, me të gjitha të drejtat e detyrimit, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe Bashkia Maliq për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM
Nr. 273, datë 16.5.2018

PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT QENDRORE TË BAZËS SË TË DHËNAVE PËR LLOGARITJEN E TAKSËS VENDORE TË PASURISË SË PALUAJTSHME "NDËRTESE" (KADASTRA FISKALE)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazën e të dhënave shtetërore", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Regjistri Qendror i Bazës së të Dhënave për Llogaritjen e Taksës Vendore mbi Pasurinë e Paluajtshme "ndërtesë" (RQTVPP) administrohet në formë elektronike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë (DPTP).

2. DPTP-ja është institucioni përgjegjës për krijimin, mbajtjen, administrimin dhe bërjen të disponueshëm të informacionit që përmban baza e të dhënave të RQTVPP (sistemi elektronik i subjekteve kontrolluese).

Krijimi i RQTVPP-së realizohet në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), në përputhje me përcaktimet e legjislacionit të fushës.

Popullimi i vazhdueshëm i të dhënave në RQTVPP, për efekt të vlerësimit të bazës së taksës vendore për ndërtesat, për rrjedhojë edhe të taksës vendore të ndërtesës, bëhet nga njësitë e

vetëqeverisjes vendore nën monitorimin dhe asistencën e DPTP-së, në bazë të aksesit për territorin në juridiksionin administrativ përkates.

3. RQTVPP-ja përban të dhëna në nivel kombëtar vetëm për qëllimin e llogaritjes së taksës së pasurisë së paluajtshme. Këto të dhëna përpunohen dhe analizohen nga DPTP-ja, që është dhënësi i vetëm i informacionit që përmban ky regjistër.

4. Të dhënat që përmban RQTVPP-ja ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

4.1 Të dhënat parësore janë:

a) Të dhënat nga vetëdeklarimi dhe/ose verifikimi në terren, si më poshtë vijon:

i) çmimi për metër katror i pasurisë së paluajtshme, për efekt taksimi;

ii) sipërfaqja e ndërtesës/njësies pronësore, e shoqëruar sipas kateve përkatesë;

iii) vlera e pasurisë së paluajtshme, për efekt të taksës së pasurisë;

iv) ndarja e kategorisë së ndërtesës/njësies pronësore, për efekt të taksës së pasurisë;

v) nënkategorizimi në bazë të vjetërsisë së ndërtesës;

vii) koordinatat GPS të vendndodhjes së pasurisë së paluajtshme ndërtesës/njësies pronësore;

viii) nënkategorizimi sipas destinacionit apo destinacioneve të përdorimit të ndërtesës/njësies pronësore;

viiii) të dhëna të tjera plotësuese nga njësitë e vetëqeverisjes vendore që shërbejnë vetëm për identifikimin e pasurisë për efekt taksimi.

b) Të dhënat nga procesi i korrigjimit;

c) Vlerësimi për detyrimin e taksës vjetore të pasurisë sipas metodologjisë;

ç) Kodi unik për identifikimin e ndërtesës/njësies pronësore për efekt të taksës së pasurisë;

d) Ndarja zonale për përcaktimin e çmimit të vlerësuar sipas metodologjisë;

dh) Ndarja zonale për përcaktimin e shkallës së taksës sipas metodologjisë;

e) Sipërfaqja e prezumuar sipas vjetërsisë së ndërtesës;

e) Rastet e përjashtimeve sipas dispozitave ligjore të neneve 6, 21 dhe 22, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar;

f) Kategorizimi i ndërtesës në proces ndërtimi sipas metodologjisë;

Faqe | 4671